



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RELACION

MBI MIRATIMIN E PROJEKTIT “PROJEKTI I RRUGËS VODICË-QAFË DARDHË”

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkia Berat në kuadër të projekteve të zhvillimit të turizmit dhe infrastrukturës lidhëse me sítet e ekoturizmit, ka realizuar përgatitjen e projektit teknik me objekt: “ Rruga Vodice -Qafë Dardhë”.

Projekti synon rritjen e aksesit nga Berati drejt fshatit turistik malor Qafë Dardhë, Njësia Administrative Roshnik, Bashkia Berat, duke bërë të mundur shtrirjen e atraksioneve të turizmit natyror dhe afrimin me destinacionin e Parkut Natyror të Malit të Tomorrit.

Fshati Qafë Dardhë ndodhet në lindje të Qytetit të Beratit rrëzë malit të Tomorrit. Ky fshat shtrihet në një zonë kodrinore-malore, me një panoramë natyrore tërheqëse për turizem. Fshati Qafë Dardhë është një vend ideal për kampingje, ku mund të shijohet e gjithë bukuria natyrore e malit të Tomorrit, gjithashtu është dhe një destinacion për të vizitorët të cilët duan t'a shijojnë nga afër natyrën; si marshime, ngjitje drejt Malit të Tomorrit, kanoe në dy liqenet akullnajore të Dardhës, eksplorim në disa atraksione natyrore si Shpellat e Terroës dhe Shpella e Barutit, Ujëvara e Beckës, rrënojat e Kalasë së Tomorrit, Sterat e dëborës, livadhet e Shën Pjetrit dhe Çezma e Tarikos.

Në këtë fshat organizohet në javën e parë të Qeshorit event i turizmit malor, si një formë për të tërhequr turistë vendas dhe të huaj për të njohur resurset që ka kjo zonë, si dhe për të kombinuar zhvillimin e agro-turizmit me produkte tipike të zonës.

Aktualisht rruga që lidh Vodicën me Qafë Dardhën është në gjendje shumë të agravuar. Ajo ka kullim të dëmtuar, me gropa dhe e vështirë për t'u përshkuar. Në disa zona është shumë e rrezikshme për t'u kaluar për shkak dhe të terrenit malor. Mungon rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza, si dhe rrjeti i kanalizimeve të ujrave të bardha, gjithashtu nuk ka ndriçim, as sinjalistikë orientuese.

Qëllimi i projektit është rikonstruksioni dhe ndertimi i ri i aksit të rrugës nga kryqëzimi i rrugës Berat-Polican në fshatin Vodice deri në fshatin Qafë Dardhë me një gjatësi 17.10 km dhe një degëzim rrugë drejt fshatit Bodgan. Në hartën e mëposhtme tregohet gjurma e këtij aksi rrugor;



Ky investim do të ketë një impakt të jashtëzakonshëm për zhvillimin e zonës dhe gjithë Njësisë Administrative Roshnik,por në nivel makro për gjithë zhvillimin turistik të Qarkut Berat, pasi krijon lehtësi në qarkullim drejt pikave malore turistike të Qafë Dardhës dhe Malit të Tomorrit, duke rritur kohëzgjatjen e qëndrimit të turistëve.

Duke patur parasysh fluksin prej 800,000 vizitorësh në vitin 2023 në Berat, dhe rritjen eksponenciale çdo vit, impakti i këtij investimi do të jetë i menjëhershëm në përthithjen e të paktën 50,000 vizitorëve në vit në vitin e parë të investimit, të cilët do të frekuentojnë Qafë Dardhën dhe Malin e Tomorrit.

Nga ana tjetër investimi i rrugës, do të bëjë të mundur, zhvillimin e gjithë zonës,pasi banorët janë të gatshëm të investojnë me kthimin e banesave dhe shtëpive të tyre në bujtina dhe krijimin e fermave turistike ku do të ofrojnë mikpritjen për vizitorët.

Në mënyrë që projekti të aplikohet për financim, është e nevojshme miratimi i projektit për Bashkinë Berat për të avancuar me procedurat e mëtejshme.

Faleminderit!

REPUBLIKA E SHQIPËSË
 KRYETARI I BASHKISË
 Ervin DEMO
 BASHKIA BERAT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKT-VENDIM

**“MIRATIMIN E PROJEKTIT “PROJEKTI I RRUGËS VODICË-QAFË DARDHË”,
BERAT**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 7, neni 8, neni 9, pika 1.1, germa”a”, neni 23, neni 54, shkronja “k”, i ndryshuar, ligji 107/2014 “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit” I ndryshuar, ligj Nr. 8402, datë 10.9.1998 Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, I ndryshuar, këshilli Bashkiak Berat në mbledhjen e datës ____ . ____ .2024 :

VENDOSI :

1. Të miratohet projekti me objekt “Projekti i rrugës Vodicë-Qafë Dardhë”, Berat
2. Me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë Berat, Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve Dhe Monitorimit Të Investimeve, Drejtoria E Mbrojtjes Civile, Transportit, Pronave dhe Shërbimeve dhe Drejtoria Juridike.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar.

KRYETAR

I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin CECA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

RELACION

MBI MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2025-2027

Të nderuar këshilltarë!

Në përputhje me nenet 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, dhe Udhëzimit nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësisive të vetëqeverisjes vendore ” i ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka nxjerrë udhëzim nr. 3 datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e PBA vendor 2025-2027”, i cili përmban:

- a) Shtojca 1 : Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për rritjen e pagave për bashkitë dhe qarqet për periudhën 2025-2027;
- b) Shtojca 2 : Struktura e Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor, 2025-2027
- c) Shtojca 3 : Treguesit kryesorë të kuadrit makroekonomikë e fiskalë 2025-2027
- d) Shtojca 4 : Lista orientuese e Produkteve Standarde sipas 20 programeve buxhetore të NJVQV-ve
- e) Shtojca 5 : Metodologjia e re e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit 2025 për Bashkitë: Korçë, Gjirokastrë, Mirditë, Berat, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Shijak, Shkodër dhe Belsh
- f) Shtojca 6 : Manuali i përdorimit të Sistemit të Menaxhimit të Pushtetit Vendor (SMBV)
- g) Shtojca 7 : Detyrat e Sugjeruara dhe Afatet e Brendshme për Miratimin e Projekt Dokumentit të PBA (Faza 1)
- h) Shtojca 8 : Detyrat e Sugjeruara dhe Afatet e Brendshme për Miratimin e Dokumentit të Rishikuar të PBA (Faza 2)

Në Udhëzimin nr. 3 datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e PBA vendor 2025-2027”, pika I , 21, cilësohet se Bashkia Berat, së bashku me bashkitë Korçë, Gjirokastrë, Mirditë, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnje, Përmet, Shkodër, Shijak dhe Belsh do të përgatisin Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 bazuar në metodologjinë e re sipas shtojcës 5, bashkëlidhur udhëzimit.

Metodologjia e re mbështetet në katër kritere të rëndësishme:

- a) Struktura e programeve buxhetore të NJVQV-ve pilot bazohet në strukturat kryesore të ofrimit të shërbimeve të NJVQV-ve (por nuk njehsohet domosdoshmërisht me to) .
- b) Ruajtja e raportimit funksional të shpenzimeve për 36 klasa të nivelit të 3-të të COFOG.
- c) Heqja e detyrimit të NJVQV-ve për të patur deri në 20 programe (të bazuara në nivelin 3 COFOG), 20 Ekiye të Menaxhimit të Programit dhe 20 DEMP.
- d) Ruajtja e një numri të menaxhueshëm të programeve buxhetore, duke shmangur problematikën e numrit shumë të madh të programeve të vogla që aktualisht përdorin njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Parimet themelore të metodologjisë së re, që do të zbatohet gjatë vitit 2024 nga këto 12 NJVQV janë:



3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

- a) Shkëputja e dimensionit të funksionit nga ai i programit për raportimin funksional të shpenzimeve. Funksioni do të identifikohet tashmë përmes kodit të produktit (dhe jo kodit të programit) për raportimin fiskal.
- b) Lejimi i NJVQV-ve që të krijojnë programe buxhetore të ngjashme me strukturat e menaxhimit të shërbimeve:
 - Kodet për programet e reja të jenë të ndryshme dhe të dallueshme nga kodet e programeve të vjetra të NJVQV-ve (shiko më poshtë Seksionin e fundit të kësaj shtojce).
 - Kodet e reja në planin e llogarive për programet e reja do të përfshihen në përgatitjen e buxhetit të NJVQV-ve dhe në sistemin e thesarit për qëllime të përgatitjes, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit.
- c) Kodet e produkteve do të mundësojnë raportim të saktë fiskal kundrejt nivelit të 3-të të COFOG (36 funksioneve të qeverisjes vendore).
- d) Dimensionin e funksionit do të përdoret vetëm për raportim dhe raportimi funksional i shpenzimeve do të kryhet përmes kodit të produktit, përcaktuar si më poshtë në shtojcë.
- e) Përgatitja dhe Zbatimi i Buxhetit të Vitit 2025 për këto 12 bashki do të bëhet në nivel produkti, krahas klasifikimeve të tjera buxhetore të përcaktuara me ligj.

Bazuar në metodologjinë e re për përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit:

- a) Drejtuesit e programeve të NJVQV, në vitin 2025, do të menaxhojnë zbatimin e një vëllimi më të madh burimesh financiare që më parë ishin të fragmentuara në një numër të madh programesh të bazuara në nivelin 3 të COFOG.
- b) Madhësia mesatare e buxhetit të programeve individuale do të rritet, duke u lejuar drejtuesve më shumë fleksibilitet në zbatim, në përgjigje të ngjarjeve të paparashikuara dhe të paparashikueshme
- c) Kjo përmirëson ndjeshëm mundësinë për të planifikuar dhe shpërndarë burimet në mënyrë korrekte për programet dhe produktet në përgatitjen e PBA 2025-2027 dhe në përgatitjen e Buxhetit të Vitit 2025. NJVQV-të duhet të përmirësojnë procesin e buxhetimit nëpërmjet:
- d) Finalizimit të kujdesshëm i produkteve të PBA 2025-2027.
- e) Përfshirja e produkteve të PBA 2025-2027 në Buxhetin e Vitit 2025.
- f) Rishikimi i produkteve të vitit 2025 në dokumentin e PBA-së 2025-2027 në përgjigje të çdo udhëzimi të Këshillit Bashkiak për ndryshimin e produkteve të Buxhetit të Vitit 2025.

I. Tavanet Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm

- Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe në vlerësimet afatmesme të transfertave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027, në nivel programi buxhetor.
- Kuadri Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2025-2027 i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41 datë 24.01.2024, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027. Kuadri makroekonomik e fiskal pasqyron parashikime të treguesve ekonomikë dhe financiarë të buxhetit të qeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme. Nëpërmjet vlerësimeve të paraqitura në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal, njësia e vetëqeverisjes vendore do të analizojë burimet që do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.
- Këto vlerësime përbëjnë bazën për të përcaktuar Tavanet e Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore.



4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

- Njësitet e vetëqeverisjes vendore në hartimin e projektbuxhetit për periudhën 2025-2027 dhe për përcaktimin e nivelit të pagave duhet të bazohen në kuadrin ligjor në fuqi.
- Transferta e pakushtëzuar të përgjithshme dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale për vitet 2025-2027, së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore, financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në qeverisjen vendore deri në vitin 2021. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj.

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Për Bashkinë Berat është parashikuar kjo ndarje e transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme :

○ Për vitin 2025 , shuma 443,078 mijë lekë

Në krahasim me vitin 2024 transferta është parashikuar me rritje + 25,001 mijë lekë, ose +6%.

○ Për vitin 2026 , shuma 469,991 mijë lekë

Në krahasim me vitin 2025 transferta është parashikuar me rritje + 26,913 mijë lekë, ose +6%.

○ Për vitin 2027 , shuma 499,028 mijë lekë

Në krahasim me vitin 2026 transferta është parashikuar me rritje + 29,037 mijë lekë, ose +6%.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

- Transferta e pakushtëzuar sektoriale parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2025-2027, për financimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara tek bashkitë në vitin 2016. Sipas akteve ligjore në fuqi funksionet e transferuara janë: personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH), administrimi i pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve rurale, konviktet e arsimit parauniversitar, qendrat e shërbimeve sociale. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, shpenzimeve për investime do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës. Bashkitë mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit për çdo funksion të transferuar.
- Transferta e pakushtëzuar sektoriale për periudhën 2025-2027, do të jetë 1% më e lartë për çdo vit buxhetor.
- Është parashikuar për çdo vit Transferta e pakushtëzuar sektoriale për rritjen e nivelit të pagave prej 51,667 mijë lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar sektoriale për bashkinë Berat për periudhën 2025-2027

në 000 lekë

Transferta e pakushtëzuar sektoriale	2024	2025	2026	2027
Konviktet e arsimit parauniversitar	29,350	29,350	29,644	29,940
Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimor	122,272	122,272	123,495	124,730
Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës	49,011	49,011	49,501	49,996
Arsimi parauniversitar	16,805	16,805	16,974	17,143
Mbrojtja nga zjarri	36,740	36,740	37,107	37,478
Mbrojtja sociale	25,445	25,445	25,699	25,956
Administrimi i pyjeve	6,731	6,731	6,798	6,866
Rrugët	5,987	5,987	6,047	6,108
Ujitja dhe Kullimi	16,793	16,793	16,961	17,130
Rritja e nivelit të pagave	28,702	51,667	51,667	51,667
Total Transf. e pakushtëzuar sektoriale	337,836	360,801	363,892	367,015

Transferta e kushtëzuar

- Transferta e kushtëzuar parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2025-2027, për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Shuma e transfertave të kushtëzuara do të jetë rezultat i shpenzimeve sipas artikujve për çdo aktivitet që kryhet në zbatim të funksioneve të deleguara. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, dhe shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, do të bëhen ne përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës.

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

- Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, si burim financimi i funksioneve të bashkisë, për periudhën 2025-2027 parashikohen të jenë :
për vitin 2025 parashikohen të jenë 637,974 mijë lekë,
për vitin 2026 parashikohen të jenë 646,481 mijë lekë, me rritje + 8,507 mijë lekë në krahasim me vitin 2025 ose +1.3% ;
për vitin 2027 parashikohen të jenë 651,975 mijë lekë, rritje + 5,494 mijë lekë në krahasim me vitin 2026 ose +0.8%.

Parashikimi i të ardhurave 2025-2027

në mijë lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

Parashikimi i të Ardhurave 2025-2027 (në 000lekë)

BURIMET BUXHETORE	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
	Fakt	Fakt	Fakt	Plani	Plani	Plani	Plani
A Të Ardhura nga Burimet e Veta	412,235.047	454,534.097	436,003.962	644,976.730	637,974.150	646,481.489	651,974.690
A.1 Të Ardhura nga Taksat Lokale	138,588.546	161,718.280	131,987.466	179,235.073	183,721.280	188,343.396	193,102.575
A.1 Taksa vendore mbi biznesin e vogël	5,447.000	959.863	1,340.098	-	-	-	-
A.1 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	65,914.531	68,264.798	66,240.000	79,162.527	80,980.616	82,854.569	84,783.325
A.1 Taksa mbi ndërtesën	45,328.000	47,279.107	45,040.000	52,839.849	54,424.918	56,058.859	57,740.000
A.1 Taksa mbi tokën bujqësore	13,942.147	13,984.602	14,157.000	18,555.325	18,555.325	18,555.325	18,555.325
A.1 Taksa mbi truallin	6,644.384	7,001.089	7,043.000	7,767.353	8,000.373	8,240.385	8,488.000
A.1 Taksa vendore në shërbimin hotelier	1,274.255	5,499.602	6,308.000	6,841.100	7,046.333	7,257.723	7,475.000
A.1 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet	53,850.000	76,160.522	47,327.000	79,500.000	81,885.000	84,341.550	86,872.000
A.1 Taksa e tabelës	2,764.143	2,381.616	2,207.368	2,596.196	2,674.081	2,754.304	2,837.000
A.1 Taksa e përkohëshme 2	9,338.617	8,451.879	8,565.000	11,135.250	11,135.250	11,135.250	11,135.250
A.2 Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	53,947.722	56,728.620	64,311.129	54,148.262	55,772.709	57,445.890	59,170.228
A.2 Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë	3,298.637	3,566.516	1,917.070	3,182.700	3,278.181	3,376.526	3,478.104
A.2 Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	33,403.934	33,674.181	37,305.168	31,084.362	32,016.892	32,977.399	33,967.124
A.2 Taksa e rentës minerare	-	10.000	179.305	178.000	183.340	188.840	195.000
A.2 Taksa mbi të ardhurat personale	17,245.151	19,477.923	24,909.586	19,703.200	20,294.296	20,903.125	21,530.000
A.3 Të Ardhurat nga Tarifat Vendore	173,181.667	188,804.679	189,213.127	244,158.860	245,702.319	247,292.084	248,929.919
A.3 Tarifa me menaxhimit të mbetjeve	78,588.936	85,713.737	83,662.000	104,777.200	104,777.200	104,777.200	104,777.200
A.3 Tarifa e pastrimit për familjet	-	28,654.927	28,860.000	46,910.500	46,910.500	46,910.500	46,910.500
A.3 Tarifa e pastrimit për institucionet	-	2,201.000	2,097.000	2,368.000	2,368.000	2,368.000	2,368.000
A.3 Tarifa e pastrimit për biznesin	78,588.936	54,857.810	52,705.000	55,498.700	55,498.700	55,498.700	55,498.700
A.3 Tarifa për ndriçimin publik	34,003.906	38,009.156	36,590.000	47,683.000	47,683.000	47,683.000	47,683.000
A.3 Tarifa për ndriçimin publik nga familjet	-	18,988.075	18,832.000	28,809.400	28,809.400	28,809.400	28,809.400
A.3 Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	-	440.000	408.000	464.000	464.000	464.000	464.000
A.3 Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	34,003.906	18,581.081	17,350.000	18,409.600	18,409.600	18,409.600	18,409.600
A.3 Tarifa për gjelbërimin	27,975.751	31,375.927	31,087.000	40,250.000	40,250.000	40,250.000	40,250.000
A.3 Tarifa për gjelbërimin nga familjet	-	18,812.447	18,851.000	27,290.850	27,290.850	27,290.850	27,290.850
A.3 Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet	-	496.000	463.000	524.000	524.000	524.000	524.000
A.3 Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	27,975.751	12,067.480	11,773.000	12,435.150	12,435.150	12,435.150	12,435.150
A.3 Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	18,783.427	18,394.822	22,465.127	25,666.660	26,436.659	27,229.759	28,046.106
A.3 Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	22.000	-	-	-	-	-	-
A.3 Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura	314.000	-	-	-	-	-	-
A.3 Tarifa e parkimit për mjetet e licensuara dhe vendpa	3,858.273	4,570.567	2,515.127	3,111.900	3,205.257	3,301.415	3,400.002
A.3 Tarifa për dhënie license për tregtimin e naftës brutc	2,938.000	2,083.920	1,388.000	2,220.000	2,286.600	2,355.198	2,426.000
A.3 Tarifa për pyjet dhe kullotat	10.000	164.000	1,363.000	2,411.474	2,483.818	2,558.333	2,635.104
A.3 Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksj	479.000	376.600	1,280.000	334.184	344.209	354.535	365.000
A.3 Tarifa për zënie dhe përdorimin e hapsirës publike	10,712.154	10,705.867	15,237.000	16,761.600	17,264.448	17,782.381	18,316.000
A.3 Tarifa për linjat ajrore dhe nëntokore (Telefoni, En	450.000	493.868	682.000	827.502	852.327	877.897	904.000
A.3 Tarifa nga dokumentat për tender, ankad etj	-	-	-	-	-	-	-
A.3 Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sport	10,977.368	13,323.290	12,775.000	20,921.000	21,548.630	22,195.090	22,861.512
A.3 Mensa (Konviktet)	234.576	522.000	400.000	1,500.000	896.100	922.983	951.000
A.3 Kopshtet	8,087.000	9,587.000	9,334.000	16,291.000	17,615.060	18,143.512	18,688.002
A.3 Çerdhet	2,655.792	3,214.290	3,041.000	3,106.000	3,012.750	3,103.133	3,196.141
A.3 Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	-	-	-	-	-	-	-
A.3 Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	2,162.250	1,757.747	1,769.000	3,150.000	3,244.500	3,341.835	3,442.101
A.3 Tarifa e përkohëshme	-	-	-	-	-	-	-
A.3 Tarifa të tjera	690.029	230.000	865.000	1,711.000	1,762.330	1,815.200	1,870.000
A.4 Të Ardhurat e Tjera	46,517.112	47,282.518	50,492.241	167,434.535	152,777.842	153,400.119	150,771.968
A.4 Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	25,124.112	33,450.000	10,043.000	94,570.649	95,517.888	96,493.545	97,498.000
A.4 Kthimi nga investimet kapitale	9,817.000	-	604.000	13,505.932	-	-	-
A.4 Shitja e mallrave dhe shërbimeve	-	395.000	-	-	-	-	-
A.4 Kundravajtjet administrative (Gjambat)	11,576.000	6,709.980	7,441.503	49,550.000	47,452.000	47,098.620	43,466.014
A.4 Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	-	-	25,292.738	-	-	-	-
A.4 Të tjera	-	6,727.538	7,111.000	9,807.954	9,807.954	9,807.954	9,807.954
B Transferta nga Buxheti Qendror	1,339,237.931	1,378,988.951	1,633,414.287	755,913.061	803,879.038	833,883.379	866,042.634
B.1 Transferta e Pakushtëzuar	298,960.088	334,516.738	432,253.651	418,077.193	443,078.000	469,991.000	499,028.000
B.2 Transferta e Kushtëzuar	748,620.356	741,770.577	893,257.123	-	-	-	-
B.2 Për funksionet e deleguara	447,580.715	488,116.375	465,503.838	-	-	-	-
B.2 Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)	301,039.641	253,653.682	427,753.285	-	-	-	-
B.3 Trasferta e Pakushtëzuar Sektoriale	291,657.487	302,702.156	307,903.513	337,835.868	360,801.038	363,892.379	367,014.634
C Huamarrja	-	-	-	-	-	-	-
D Trashëgimi nga Viti i Shkuar	123,204.259	144,843.123	212,673.236	196,764.212	-	-	-
D.1 Trashëgimi Pa Destinacion	120,818.810	134,198.800	210,563.838	194,925.099	-	-	-
D.2 Trashëgimi Me Destinacion	2,385.449	10,644.323	2,109.398	1,839.113	-	-	-
TOTALI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË	1,874,677	1,978,366	2,282,091	1,597,654.003	1,441,853.188	1,480,364.868	1,518,017.324



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

Parashikimi i tavanëve përgatitore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, që do të shërbejnë për procesin e planifikimit të shpenzimeve, është si më poshtë:

TAVANET PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027

Tavanet për çdo Program të Bashkisë Berat për 2025-2027 (mijë lekë)

Kodi	Emërtimi i Programeve	2025			2026			2027		
		Totali	Shpenzime Korente	Kapitale	Totali	Shpenzime Korente	Kapitale	Totali	Shpenzime Korente	Kapitale
AA102	Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse	173,107	170,505	2,602	177,250	174,750	2,500	181,694	179,694	2,000
AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat	529,904	401,904	128,000	551,493	407,207	144,286	636,742	430,510	206,232
AC102	Arsimi & Kujdesi Social	474,970	389,970	85,000	482,430	400,500	81,930	418,636	408,636	10,000
AD102	Bujqësia, Administrimi i Pyjeve, Ujërave, Shërbimeve dhe Mbrojtja e Territorit	45,999	43,999	2,000	45,586	44,586	1,000	46,602	45,602	1,000
AE102	Siguria dhe Mbrojtja e Territorit	75,963	75,463	500	77,556	76,556	1,000	78,815	77,815	1,000
AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet	127,910	122,410	5,500	132,050	126,050	6,000	139,528	132,528	7,000
AG102	Rezerva & Kontigjenca	14,000	14,000	0	14,000	14,000	0	16,000	16,000	0
	Totali	1,441,853	1,218,251	223,602	1,480,365	1,243,649	236,716	1,518,017	1,290,785	227,232



8

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

Drejtoritë dhe ndërmarrjet e varësisë do të përgatisin kërkesat shtesë të cilat do t'i paraqiten Kryetarit të Bashkisë.

Drafti i parë i plotë do të paraqitet për miratim nga Këshilli Bashkiak brenda muajit Qershor 2024.

Ju faleminderit !

GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

Ervin DEMO	Kryetar i Bashkisë (NA)	
Arisa TOSKA	Sekretar i Përgjithshëm (Koordinator)	
Rovena SHEHU	Drejtor i Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave (Sekretar i GMS)	
Luçiano BOJAXHIU	N/Kryetar i Bashkisë	
Joana MELËNGU	N/Kryetar i Bashkisë	
Arjan SHKËMBI	N/Kryetar i Bashkisë	
Luçiano BOJAXHIU	Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve	
Etleva DHIMA	Drejtor i Integritit European dhe Planifikimit Strategjik	
Sokol TOSKA	Drejtor i Taksave dhe Tarifave	
Gentian DASHI	Drejtor i Burimeve Njerëzore	
Petro SINJARI	Drejtor i Drejtorisë Juridike	
Erlin KUÇI	Drejtor i Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve	
Silvana MERDANI	Drejtor i Turizmit dhe Aktiviteteve	
Kreshnik ZAIMI	Drejtor i Policisë Bashkiake	
Artan MERKO	Drejtor i repartit të MZSH	
Piro XHEBLATI	Drejtor i Shërbimit Social	
Majlinda RAMA	Drejtor i Arsimit, Kulturës dhe Rinisë	
Bledar ÇILI	Drejtor i NJSH Agjencia së Shërbimeve Publike	
Arjan SHKËMBI	Drejtor i NJSH Drejoria e Bujqësisë, administrim pyje, ujëra e shërbim veterinar	
Klodiana HOXHA	Drejtor i NJ.SH. Drejtoria Arsimore	
Arben QAFA	Drejtor i NJ.SH. Qendra Kulturore " Margarita Tutalani"	
Alma KULE	Drejtor i NJ.SH. Qendra "LIRA"	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

RELACION

**“MBI MIRATIMIN E FONDEVE PËR NDËRHYRJEN EMERGJENTE TË
PROJEKTIT ”NDËRTIMI I URES NË FSHATIN LAPARDHA 2”**

Të nderuar Këshilltarë!

Nisur nga kërkesat e banorëve të fshatit Lapardha 2, njesia administrative Otllak për ndërtimin e një ure e cila do tju shërbeje banorëve dhe fermerëve. Kjo urë do te shërbejë për këto nevoja:

1. Ndiemon fermerët dhe banorët për të shkuar në tokat dhe banesat e tyre ku aktualisht në kohë të thatë kalojnë përmes lumit dhe kur ka prurje lumi duke gjetur mënyra alternative që u vështirëson lëvizjen.
2. Për të përmisuar shërbimin në shkollën fillore, kopshtin, qendrën shëndetësore, 10 bizneseve tregtare dhe 20 bizneseve bujqësore.
3. Kjo urë do të shërbejë si urë lidhëse midis fshatrave Shegjës, Bardhaj Vodëz, njesia Lumas dhe dy fshatrave te njesisë Perondi.

Në mbështetje të ligjit nr 45/2019 “ Për mbrojtjen civile” dhe të VKM nr 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” pika 3.1 gërma b, pika 5 , shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes nr 86/6 prot datë 27.03.2023” Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2024 ku Bashkisë Berat i është akorduar fondi në shumën 12,089,292 lekë, ku është ndarë ne dy drejtime sipas VKM-s 414 dt.08/07/2021:

- kodi i produktit **91707AG** - "Shpenzime për marjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rrahilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes se materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve" në masën **:10,000,000 lekë.**

- 3
- Kodi i produktit **91707AB** - " Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme" në masën : **2,089,291.56** lekë.


Ju sjellim propozimet tona për të përdorur fondin e mbetur të akorduar nga buxheti i shtetit për mbrojtjen civile në shumën 10,000,000 dhe pjesën tjetër në shumën 1,999,986 nga Fondi i Investimeve Buxheti i Bashkisë.

Këto ndërhyrje shërbejnë për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese , mbrojtëse dhe rehabilituese në objektet infrastrukturore që përbëjnë një kërcënim serioz për jetën e njerëzve, pronave të tyre dhe mjedisin, të cilat ndikojnë në rikthimin e jetës normale për komunitetin dhe veprimtarinë e tij ekonomike , në përputhje me pikën 3.1 gërma b të VKM-së.

Bashkangjitur projekti me objekt “ Ndertimi I Urës Në fshatin Lapardha 2 “ dhe preventivi.

KRYETARI

Ervin Dema





BASHKIA BERAT

PREVENTIV PUNIMESH

Objekti: Ndertimi i shtatullave te Ures se Lapardhas 2

Nr	Analize	Emertimi	Njesi	Sasi	Cmimi	Vlera
1	2.3	Germim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m3.shkarkimi ne auto	m3	844	150	126,533
2	AN	Shpim me sonde Ø 0.8 m, ~ 15 m	ml	120	6,000	720,000
3	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	72	14,943	1,075,896
4	3.248	Struktura monolite betoni me gakell C 30/37	m3	183	19,406	3,551,298
5	3.289	F V hekur betoni periodik, C-5, Ø > 12mm	ton	32.3	123,769	3,997,739
6	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	97	958	92,926
7	3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	97	818	79,346
8	3.331	Gabiona me rrije te zinguar e gure kave 1x1x1 m	m3	50	7,125	356,250
SHUME						9,999,988
TVSH						1,999,998
TOTAL						11,999,986

Putnoi:
Ing. Erida Nasufi
Ing. Valentina Karabina

Miratoi

Kryetari i Bashkise

Ervin Iseni





BASHKIA BERAT

PREVENTIV PUNIMESH

Objekti: Ndertimi i shpatullave te Ures se Lapardhas 2

Nr	Analize	Emeritimi	Njesi	Sasi	Cmimi	Vlera
1	2.3	Gerrim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m3,shkarkimi ne auto	m3	844	150	126,533
2	AN	Shpim me sonde Ø 0,8 m, ~ 15 m	ml	120	6,000	720,000
3	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	72	14,943	1,075,896
4	3.248	Struktura monolite betoni me çakell C 30/37	m3	183	19,406	3,551,298
5	3.289	F V hekur betoni periodik, C-5, Ø > 12mm	ton	32.3	123,769	3,997,739
6	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	97	958	92,926
7	3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	97	818	79,346
8	3.331	Gabiona me rrije te telit te zinguar e gure kave 1x1x1 m	m3	50	7,125	356,250
SHUME						9,999,988
TVSH						1,999,998
TOTAL						11,999,986

Puno:

Ing. Erida Nasufi

Ing. Valentina Karabina

Miratoi

Kryetari i Bashkise

Ervin Dema





BASHKIA BERAT

PREVENTIV PUNIMESH

Objekti: Nderimi i shpatullave te Ures se Lapardhas 2

Nr	Analize	Emertimi	Njesi	Sasi	Cmimi	Vlera
1	2.3	Germim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m3,shkarkimi ne auto	m3	844	150	126,533
2	AN	Shpim me sonde Ø 0.8 m, ~ 15 m	ml	120	6,000	720,000
3	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	72	14,943	1,075,896
4	3.248	Struktura monolite betoni me gakell C 30/37	m3	183	19,406	3,551,298
5	3.289	F V hekur betoni periodik, Ç- 5, Ø > 12mm	ton	32.3	123,769	3,997,739
6	3.211	Shtrese gækelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	97	958	92,926
7	3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	97	818	79,346
8	3.331	Gabiona me trjete teji te zinguar e gure kave lxlxl m	m3	50	7,125	356,250
SHUME						9,999,988
TVSH						1,999,998
TOTAL						11,999,986

Punoi:

Ing. Erida Nasufi

Ing. Valentina Karabina

Miratoi

Kryetari i Bashkise

Ervin Demo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE , PRONAVE TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

MBI SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR BANORËT E BANESAVE SOCIALE

Të nderuar Këshilltare !

Bashkia Berat ka planifikuar në buxhetin e saj për vitin 2024 , fond për subvencionimin e qirasë për familjet me probleme sociale dhe ekonomike , që kanë në përbërjen familjare persona me aftësi të kufizuar,invalidë ,që kanë të ardhura familjare mujore shumë të ulta kryesisht me pension dhe me përkrahje sociale, që plotësojnë kriteret e përcaktuara sipas nenit, 2 pika 34,42,45 dhe nenit 30 të ligjit nr.22/2018, ", ligjin nr.48/2023 "Pwr disa ndryshime dhe shtesa nw ligjin nr.22/2018 " Për strehimin social".

Bashkia Berat duke filluar nga viti 2014, paguan çdo vit këstin e kredisë nga banka e Këshillit te Europës (CEB-i) ku bashkia ka detyrim të shlyeje principalin e kredise , ndersa Qeveria interesat e saj.Deri tani kemi shlyer vlerën e kredisë në shumën prej 531,967.4 € dhe na mbetet për të shlyer deri ne vitin 2026 shuma prej 55,741€.

Bashkia nuk e ka rritur qirane e llogaritur sipas vkm nr. 522, datë 25.7.2019 e cila është për apartamentet 1+1 është 6,994 lekë/muaj dhe për garsoniere , qiraja është 5,225 lekë/muaj. Për fillimin e procedurën së subvencionimit të qirasë, bashkia ka njoftuar të gjitha familjet e adres mos përjashtuar asnjë për të sjellë dokumentacionin e plotë të të ardhurave familjare mujore bazë,për llogaritjen e masës së subvencionimit të qirasë .

Komisioni i Strehimit i mbledhur me date 05.04.2024 , ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë , pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar në bashki , nga banorët e strehuar në banesat sociale konkludoi si më poshtë :

Nga 49 familje të strehuara në apartamentet e banesave sociale, perfitojnë subvencionim te qirase 35 familje ndersa 14 familje nuk e përfitojnë .

Kërkojme nga ana Juaj miratimin e listës së familjeve të përbërë nga 35 familje që u kualifikuan nga Komisioni i Strehimit .

Bashkelidhur lista e perfituesve dhe masa e subvencionimit e llogaritur për çdo familje .

Drejtori
Erlin Kuçi